

 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar rreth:	20.09.2021
Zyra e pranimit:	No. i protokolit
308	01-253

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Kjo marrëveshje mirëkuptimi për zbatimin e projektit "NDAJE DIJEN " të financuar nga Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) në kuadër të Agjencionit Austriak për Zhvillim (ADA), është e lidhur në mes të **Universitetit "Ukshin Hoti"** dhe Grupit joformal "**Malala**".

Qëllimi i kësaj marrëveshje mirëkuptimi është sigurimi i zbatimit të fushatës "NDAJE DIJEN" përmes të cilës do të krijohet këndi i leximit brenda universitetit dhe do të sigurohen një numër i konsiderueshëm i titujve, të cilët do të shfrytëzohen nga ana e studentëve.

Përmes kësaj marrëveshje mirëkuptimi, **Universiteti "Ukshin Hoti"** zotohet se do të sigurojë një hapësire brenda universitetit, e cila do të shfrytëzohet nga studentët si kënd leximi dhe aprovon përdorimin e logove të Agjencionit Austriak për Zhvillim (ADA) dhe organizatës ORCA brenda këndit të leximit.

Ndërkohë që **Grupi joformal "Malala"** merr përsipër evidentimin e librave dhe gjëseneve të tjera në këndin e leximit.

Marrëveshja është nënshkruar në 2 kopje origjinale, prej të cilave 1 kopje mbahet nga Universiteti Ukshin Hoti dhe 1 kopje nga përfaqësuesi i projektit nga studentët.

Kjo marrëveshje u nënshkrua në kohën kur menaxhmenti i Universitetit "**Ukshin Hoti**" janë në funksionet e ushtruesve të detyrave respektive, në rast se menaxhmenti i ardhshëm nuk ka vullnet për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, përmes një njoftimi paraprak mund ta ndërpresë bashkëpunimin me palët bashkëpunuese.

Kjo marrëveshje u nënshkrua sot, me datë 20.09.2021.

Universiteti "Ukshin Hoti"

U.d. Rektor-Samedin Krrabaj



Grupi joformal "Malala"

Angelika Berisha



Titulli i projektit

NDAJE DIJEN

<p>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE <i>(shkruani shkurtimisht pikat kyçe të projektit - deri në 250 fjalë)</i></p>	<p>Kampanja "NDAJE DIJEN" është një iniciativë që buron nga një grup i studentëve të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.</p> <p>Kjo kampanjë synon të krijojë këndin e librit brenda hapësirës së universitetit "Ukshin Hoti" Prizren., e cila do të shfrytëzohet nga studentët për rivitalizimin e jetës studentore brenda dhe jashtë universitetit.</p> <p>Ky kënd i librit do të përdoret nga studentët e universitetit si pikënisje për lindjen e forumeve të reja studentore të cilat do të adresojnë çështje të ndryshme universitare që lidhen me arsimin e lartë, integritetin akademik, nxitjen e vetëdijes kritike etj. Këndi i librit do të ketë një ose më shumë koordinator të cilët do të përzgjidhen me rotacion që të përkujdesen për evidentimin e librave që shfrytëzohen nga studentët, do angazhohen që të krijojnë një plan të aktiviteteve dhe t'i zbatojnë ato, si p.sh: klubet e librit, klubet e debatit, natën e filmit, diskutime rreth problematikave studentore, nata e poezisë etj.</p> <p>Në këtë hapësirë do të investohen 1500 euro, rregullimi i hapësirës 500 euro (blerja e raftëve, bean-bags, ngjyrosja e hapësirës, etj.) 100 euro do të shfrytëzohen për eventin promovues të këndit të librit me një koktej rasti me ç'rast do të ftohen kontribuuesit e kësaj fushate, duke respektuar masat në fuqi nga Qeveria për mbrojtje ndaj pandemisë. 900 euro të tjera do të investohen në libra (aplikantët do vijnë me një propozim për X tituj (bazuar në Fakultetet aktive që janë në Universitet).</p>
<p>QËLLIMI PËRFUNDIMTAR</p>	<p>Ngritja e vetëdijes kritike dhe nxitja për lindjen e iniciativave të reja përmes aktiviteteve të cilat do zhvillohen në bibliotekë/hapësirë.</p>

<p>OBJEKTIVAT KONKRETE <i>(shpjegoni synimet e projektit tuaj)</i></p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rrjetëzimi i studentëve të "Ukshin Hoti" Prizren. 2. Ngjallja e jetës studentore 3. Adresimi i problematikave studentore nga studentët 4. Zhvillimi i jetës studentore në sferën akademike dhe kulturore.
<p>PËRFITUESIT E PROJEKTIT <i>(përmendni grupet e synuara apo institucionet që përfitojnë nga ky projekt)</i></p>	<p>Përfitues direkt do jenë studentët të cilët do mund të shfrytëzojnë këtë kënd për aktivitetet e tyre studentore. Indirekt i gjithë Universiteti sepse do ketë kënd të studentëve, gjë kjo që do e bëj më të gjallë jetën studentore me aktivitetet e tyre në kuadër të rritjes së cilësisë dhe integritetit akademik.</p>
<p>AKTIVITETET <i>(radhitni aktivitetet e parapara në projekt, shpjegoni se si dhe për sa kohë do të realizohen ato - deri në 300 fjalë)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - Nenshkrimi i marrveshjes se bashkepunimit me stafin menaxherial te Universitetit - Sigurimi i kendit - Ngjyrosja e kendit, blerja e rafteve; blerja e bean-bags - Blerja e librave - Eventu promovues
<p>REZULTATET <i>(Shpjegoni çfarë prisni të arrini konkretisht përmes realizimit të projektit - deri në 200 fjalë)</i></p>	<p>Me implementimin e suksesshëm të këtij projekti ne synojmë të arrijmë qëllimin dhe objektivat kryesore të përcaktuara në fillim të projektit. Pra, të krijojmë një kënd i cili do jetë si pikënisje për lindjen e forumeve të reja studentore të cilat do të adresojnë çështje të ndryshme universitare që lidhen me arsimin e lartë, integritetin akademik, nxitjen e vetëdijes kritike etj. Kënd ky që do shfrytëzohet për: Klubin e debatit; Naten e filmit ; Naten e poezise, Diskutime rreth problematikave studentore etj.</p>
<p>RREZIQET <i>(Përmendni rrethanat e mundshme që mund ta ngadalësojnë apo ndikojnë në realizimin e projektit - deri në 200 fjalë)</i></p>	<p>Ngadalësimin e projektit do mund të shkatohet në rast neglizhence të afatit kohor nga bashkëpunëtorët e jashtëm, kjo do tejkalohej duke analizuar afatet kohore dhe eliminuar këtë rrezik përmes monitorimit të vazhdueshëm të aktiviteteve që do zhvillojmë. Aspektet kryesore që do kontrollohen dhe monitorohen janë : koha, buxheti dhe performanca deri në pikën e arritur , për të tejkualuar rreziqet eventuale që paraqiten</p>

	- Situata me COVID.
--	---------------------

V. BUXHETI I PROJEKTIT

Luteni që ta plotësoni tabelën e buxhetit të projektit si në vijim:

Nr.	Kategoria buxhetore	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Shuma e përgjithshme e kategorisë
1	Blerja e rafteve, bean-bags dhe ngjyrosja e hapësirës				500
2	Blerja e librave				900
3	Eventi Promovues				100
Shuma e përgjithshme e buxhetit:					1500



KEC
Qendra për Arsim në Kosovë
Kosovo Education Center

ORCA
organizata për mënyrë e cilësisë në arsim



WITH FUNDING FROM
**AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION**